

## PROCES VERBAL

### **PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS:** “Hartimi projektit të detajuar inxhinierik dhe arkitektonik për Ndërtimin e zyrave të administratës dhe reparitit mekanik të NJ.B.M.I”

**VLERA E FONDIT LIMIT:** 3,348,854 (tre milionë e treqind e dyzet e tetë mijë e tetëqind e pesëdhjetë e katër) pa tvsh.

**Projekte- 22114311-5 Shërbime**

#### **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10.*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në Nenet 76, 82 të LPP, Nenet 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(i ndryshuar).

Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 82, i LPP “162”. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari pëcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

**2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

##### **2.1 Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomikë**

Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse, në ditën e hapjes së ofertës.

##### **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar**

### 2.2.1

Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit financiare (**2023, 2024, 2025**) të paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky Autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar.

Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negative ndërmjet aktivitet dhe pasivitet.

*Shënim: Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma "c" të Ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr.10091 date 5.3.2009 "Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar" i ndryshuar.

### 2.2.2

Për të provuar kapacitetin ekonomik dhe financiar për realizimin e kontratës, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024 dhe 2025, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e kërkuara të jetë jo më e vogël se 40% e fondit limit të procedurës.

Në zbatim të këtij kriteri, vlera minimale e kërkuar e xhiros është:

**1,339,542 Lekë pa TVSH.**

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, nenin 55, pika 4 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar se ky kriter kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori

ekonomik fitues i zoteron te gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare per te permbushur me sukses kontraten

## **2.3 Kapaciteti teknik**

### **2.3.1 Përvoja e ngjashme**

Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të shërbimeve të ngjashme gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% e fondit limit të objektit që prokurohet.

Vlera minimale e kërkuar për shërbime të ngjashme është:

**669,771 Lekë pa TVSH.**

Shërbime të ngjashme do të konsiderohen:

- projektim objektsh administrative;
- projektim objektsh industriale;
- projektim magazinash ose reparte mekanike;
- projektim objektsh shërbimi;
- projektim godinash me konstruksion metalik.

Këto shërbime duhet të vërtetohen si më poshtë:

a) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë kontratën e shërbimeve të ngjashme në studim projekte/ projekte, formularin e vlerësimit për realizimin e shërbimeve të ngjashme në studim projekte/ projekte dhe faturat tatimore të shitjes të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat si dhe objekti i shërbimeve të ngjashme në studim projekte/ projekte.

b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë kontratën e shërbimeve të ngjashme në studim projekte/ projekte, formular vlerësimi/vërtetim për realizimin e shërbimeve të ngjashme në studim projekte/ projekte ku të shënohet vlera, afati i kontrates dhe objekti i shërbimeve të ngjashme në studim projekte/ projekte, të realizuar si dhe faturat tatimore të shitjes të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat si dhe objekti i shërbimeve të ngjashme në studim projekte/ projekte së realizuar.

c) Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: kontraten e bashkimit të operatoreve dhe prokuren e posacme, të deklaruara në fazën e tenderimit.

d) Për kontratat e realizuara si nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë: kontratën baze ndërmjet kontraktorit dhe autoritetit kontraktor, kontratën e nënkontraktimit dhe aktin e miratimit zyrtar si nënkontraktor.

***Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 55, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” Përcaktimi i vlerës minimale prej 20% të fondit limit është bërë në përputhje me natyrën dhe kompleksitetin e shërbimeve objekt prokurimi, me qëllim garantimin që operatorët ekonomikë disponojnë eksperiencën e nevojshme teknike dhe profesionale për realizimin me sukses të kontratës.. Duke qene se kjo procedure prokurimi do te konkludoje me nje kontrate sherbim për hartimin e projektit të detajuar inxhinierik dhe arkitektonik per te deshmuar pervojen e meparshme vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.*

### **2.3.2 Liçensa profesionale**

**Liçensa profesionale të operatorit ekonomik (e vlefshme) për projektim (leshuar nga MZHUT ose nga Institucioni i Autorizuar sipas legjislacionit në fuqi për dhënien e licensave profesionale në fushën e studimit e projektimit në ndërtim ), ku të përfshihen kategorite:**

#### **2. PROJEKTUES ARKITEKT**

a) Projektim arkitektonik për objekte civile dhe industriale;

#### **3. PROJEKTUES KONSTRUKTOR**

a) Objekte civile dhe industriale deri në 5 kate;

c) Objekte me shkallë të lartë vështirësie betonarme dhe metalike.

#### **4. PROJEKTUES INSTALATOR**

a) Projektim të instalimeve hidro-termosanitare;

c) Projektim të linjave elektrike për objekte civile dhe industriale;

f) Projektim të sistemeve kundër zjarrit;

h) Projektim i impianteve ngritëse dhe transportuese (ashensorë);

j) Projektim të rrjeteve të telefonisë, internetit, CCTV, sisteme alarmi dhe sisteme detektimi zjarri.

#### **5. PROJEKTUES HIDROTEKNIK**

b) Furnizim me ujë, kolektorë dhe shkarkime.

#### **8. PROJEKTUES GJEODET**

- a) Rilevime inxhinierike;
- b) Rilevime inxhinierike kadastrale.

## 9. STUDIME GJEOLIGO-INXHINIERIKE

- a) Studim dhe vlerësim gjeologo-inxhinierik për objekte civile dhe industriale deri në 5 kate.

## 12. STUDIME SIZMIOLOGJIKE

- a) Studime dhe vlerësime të sizmiologjisë inxhinierike për klasifikim gjeosizmik të trojeve.

*Sqarim: Për licencat e lëshuara pas hyrjes në fuqi të Vendimit nr.943, datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave ‘Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë **Liçensa profesionale të shoqërisë (e vlefshme) për projektim (lëshuar nga MZHUT ose institucione të tjera të autorizuara sipas legjislacionit në fuqi për dhënien e liçensave profesionale në fushën e studim projektimit në ndërtim), e vlefshme, ku të përfshihen kategoritë e mësipërme me ndryshimet përkatëse në emërtesë.***

***Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016” (shënim-përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor specifik dhe nenin përkatës, që parashikon licencimin e subjekteve, në lidhje me veprimtarinë përkatëse për realizimin e shërbimeve objekt kontrate).*

Kategoria e kërkuar	Pikat e kategorisë	Përshkrimi për kategoritë
Projektues Arkitekt	a) Projektim arkitektonik për objekte civile dhe industriale	Projektimi arkitektonik është i domosdoshëm për hartimin e zgjidhjes funksionale dhe arkitektonike të godinës së zyrave të administratës dhe repartit mekanik të NJ.B.M.I, organizimin e ambienteve të punës dhe shërbimit, si dhe integrimin e objektit me infrastrukturën ekzistuese dhe standardet urbanistike në fuqi.
Projektues Konstruktor	a) Objekte civile dhe industriale deri në 5 kate	Projektimi konstruktiv për objektet civile dhe industriale deri në 5 kate kërkohet për dimensionimin e elementëve strukturorë të godinës së administratës

Kategoria e kërkuar	Pikat e kategorisë	Përshkrimi për kategoritë
		dhe repartit mekanik, duke garantuar qëndrueshmërinë, sigurinë dhe përputhshmërinë me normat teknike të ndërtimit.
Projektues Konstruktor	c) Objekte me shkallë të lartë vështirësie betonarme dhe metalike	Kjo kategori kërkohet për projektimin e strukturave betonarme dhe metalike të godinës dhe repartit mekanik, përfshirë elementët me karakter industrial dhe ngarkesa specifike teknike, duke garantuar sigurinë strukturore dhe funksionale të objektit.
Projektues Instalator	a) Projektim të instalimeve hidro-termosanitare	Projektimi i instalimeve hidro-termosanitare është i nevojshëm për furnizimin me ujë, sistemet sanitare, rrjetet e shkarkimit dhe sistemet termo-hidraulike të godinës së administratës dhe repartit mekanik të NJ.B.M.I.
Projektues Instalator	c) Projektim të linjave elektrike për objekte civile dhe industriale	Kjo kategori kërkohet për projektimin e sistemeve të furnizimit me energji elektrike, ndriçimit dhe rrjeteve elektrike të nevojshme për funksionimin e zyrave të administratës dhe repartit mekanik.
Projektues Instalator	f) Projektim të sistemeve kundër zjarrit	Projektimi i sistemeve kundër zjarrit është i domosdoshëm për garantimin e sigurisë së godinës së administratës dhe repartit mekanik, përfshirë sistemet e alarmit, detektimit dhe mbrojtjes ndaj zjarrit sipas standardeve në fuqi.
Projektues Instalator	h) Projektim i impianteve ngritëse dhe transportuese (ashensorë)	Kjo kategori kërkohet për projektimin e impianteve ngritëse dhe transportuese të nevojshme për funksionalitetin dhe aksesueshmërinë e godinës së administratës dhe repartit mekanik të NJ.B.M.I.
Projektues Instalator	j) Projektim të rrjeteve të telefonisë, internetit, CCTV, sisteme alarmi	Projektimi i rrjeteve të komunikimit dhe sistemeve të sigurisë është i nevojshëm për funksionimin teknologjik, administrativ dhe monitorimin e godinës së administratës dhe repartit mekanik të NJ.B.M.I.

<b>Kategoria e kërkuar</b>	<b>Pikat e kategorisë</b>	<b>Përshkrimi për kategoritë</b>
	dhe sisteme detektimi zjarri	
Projektues Hidroteknik	b) Furnizim me ujë, kolektorë dhe shkarkime	Kjo kategori kërkohet për projektimin e rrjeteve të furnizimit me ujë, kolektorëve dhe sistemeve të shkarkimit për godinën e administratës dhe repartin mekanik, duke garantuar funksionimin normal të infrastrukturës hidroteknike.
Projektues Gjeodet	a) Rilevime inxhinierike	Rilevimet inxhinierike dhe matjet topografike janë të domosdoshme për evidentimin e gjendjes ekzistuese të territorit ku do të ndërtohen zyrat e administratës dhe reparti mekanik i NJ.B.M.I, si dhe për hartimin e saktë të projektit.
Projektues Gjeodet	b) Rilevime inxhinierike kadastrale	Rilevimet inxhinierike kadastrale kërkohen për evidentimin e kufijve pronësorë dhe koordinimin e projektit të godinës së administratës dhe repartit mekanik me të dhënat kadastrale ekzistuese.
Studime Gjeologo-Inxhinierike	a) Studim dhe vlerësim gjeologo-inxhinierik për objekte civile dhe industriale deri në 5 kate	Studimi dhe vlerësimi gjeologo-inxhinierik është i nevojshëm për përcaktimin e karakteristikave të truallit, kushteve gjeologjike dhe kapacitetit mbajtës të terrenit ku do të ndërtohen zyrat e administratës dhe reparti mekanik i NJ.B.M.I.
Studime Sizmologjike	—	Studimet sizmologjike kërkohen për vlerësimin e kushteve sizmike të zonës dhe përcaktimin e parametrave antisizmikë për projektimin e sigurt të godinës së administratës dhe repartit mekanik të NJ.B.M.I, në përputhje me standardet teknike në fuqi.

### 2.3.3

Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë mbi personelin kryesor teknik të nevojshëm për realizimin e kontratës, si dhe CV të stafit kryesor teknik të angazhuar në projekt.

#### 2.3.4

Operatori ekonomik duhet të ketë një numër mesatar prej të paktën 10 (dhjetë) punonjësish për minimumin muajin e fundit nga data e hapjes së ofertave.

Kjo kërkesë vërtetohet me:

- Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për minimumin muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.
- Listpagesat e punonjësve të konfirmuara nga autoritetet perkatese sipas formatit që kërkohej nga legjislacioni në fuqi për minimumin për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave shoqëruar me formularët e deklaramit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shendetesore.

*(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, këto dokumente do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Numri i përcaktuar i punonjësve është përllogaritur si më poshtë: për përcaktimin e fuqisë punëtore minimale të kërkuar argumentojme se jemi bazuar në shërbimet e kërkuara sipas Termave të Referencës dhe stafin e përmendur në pikat e mësipërme. **Numri minimal prej 10 punonjësish është përcaktuar në funksion të natyrës multidisiplinare të shërbimeve të projektimit, të cilat përfshijnë komponentë arkitektonikë, konstruktivë, elektrikë, mekanikë, hidroteknikë, topografikë, gjeologjikë, mbrojtje nga zjarri dhe efikasitet energjie. Ky numër vlerësohet i nevojshëm për të garantuar realizimin në kohë dhe me cilësi të kontratës.** Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë, tregon besueshmëri për autoritetin. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

#### 2.3.5 Personeli kryesor teknik

Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimalisht stafin e mëposhtëm:

- 1 (një) Arkitekt;
- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi;

- 1 (një) Inxhinier Hidroteknik;
- 1 (një) Inxhinier Topograf;
- 1 (një) Inxhinier Elektrik;
- 1 (një) Inxhinier Mekanik;
- 1 (një) Inxhinier Gjeolog;
- 1 (një) Ekspert M.Z.SH;
- 1 (një) Auditues i Eficencës së Energjisë.

***Një projektues nuk duhet të jetë i angazhuar njëkohësisht në stafin e dy shoqërive që marrin pjesë në procedurën e prokurimit.***

***Stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.***

Për stafin e mësipërm duhet të paraqiten:

- kontratë pune e vlefshme;
- diplomë;
- CV;
- deklaratë disponueshmërie.

Stafi duhet të figurojë në listpagesat e shoqërisë për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.

Një specialist nuk mund të jetë i angazhuar njëkohësisht në stafin e dy operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Njesia e prokurimit për vendosjen e stafit i është referuar Termave të përgjithshme të referencës për objektet pjesë e kësaj procedure, pjesë e secilave do të jenë të licensuar për shërbimet që priten të realizohen. Pika e licensës me sipër perkojnë perkatesisht me stafin drejtues teknik për realizimin e procedurës.

### **2.3.6 Stafi mbështetës**

Operatori ekonomik duhet të ketë si staf mbështetës:

- 1 (një) specialist të pajisur me certifikatë për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis;
- 1 (një) ekspert për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimin;
- 1 (një) topograf.

Ky kriter mund të permbushet nga operatori ekonomik edhe me anë të marrëdhënies kontraktore për ekzekutimin e kontratës, objekt prokurimi.

*(Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, të paktën njëri nga operatorët duhet të ketë pjesë të stafit të tij një specialist ne fushen e mbrojtjes nga zjarri dhe per shpetimin).*

Shenim: Për stafin e kërkuar sipas pikës 2.3.6, operatorët ekonomik në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, duhet të deklarojnë emër, mbiemër, profil i punës, numër, datë e kontratës individuale të punës, numri dhe titulli i diplomës/ kualifikimit, si dhe institucionin qe ka leshuar kete dokument.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Njesia e prokurimit per vendosjen e stafit i eshte referuar Termave te references, natyres se pergjithshme te sherbimeve qe priten te ofrohen. Prezenca e stafit te mesiperm eshte gjykuar si e domosdoshme dhe e nevojshme per nje shperndarje dhe efikasitet sa me te madh ne realizimin e sherbimeve.

### **2.3.7 Pajisjet**

Operatori ekonomik duhet të ketë në pronësi ose me qira minimalisht:

- 1 (një) Pajisje GPS për matje gjeodezike;
- 1 (një) Pajisje Total Station.

Për pajisjet duhet të paraqiten:

- faturë tatimore blerjeje; ose
- kontratë qiraje

**Shënim:** Sqarojmë se në përmbushjen e kriterit të sipërcituar, operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.10 ku të deklarohej disponimi i mjeteve Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Ndersa operatorët ekonomikë të sukseshëm duhet te dorezoje prane AK, perpara lidhjes të marrëveshjes kuadër, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

### 2.3.8 Standardet ISO

Operatori ekonomik duhet të jetë i certifikuar sipas standardeve:

- a. Certifikatë: ISO 9001/2015 -*Sistemi i Menaxhimit të cilesisë*, Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- b. Certifikatë: ISO 45001 : 2018 - *Sistemi i manaxhimit te sigurise dhe shendetit ne vendet e punes*, Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- c. Certifikatë: ISO 14001:2015-“*Sistemet e menaxhimit te ambientit*” e vlefshme, Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

*Shënim:* Kandidati ofertues në përlllogaritjen e ofertës duhet ti referohet njoftimit të bërë me Nr.5585 Prot. datë 25.07.2017 të Agjensisë së Prokurimit Publik ”Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 ”Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”

**Argumentimi:** Kerkesat e mesiperme jane vendosur bazuar ne Nenin 79, pika 1 te Ligjit Nr. 162/2020, “Per prokurimin publik”(i ndryshuar), sipas të cilit: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe ne zbatim te Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”

Çertifikatat e cilesise jane bazuar ne perputhje jane ne perputhje me natyren dhe objektin e kontrates qe prokurohet.

**Të gjitha dokumentet duhet të paraqiten në përputhje me kërkesat e dokumenteve të tenderit dhe legjislacionin në fuqi për prokurimin publik.**